



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0023

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AAB CONSTRUCTION SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i i parkut në Hajvali me numër të prokurimit 616-25-1776-5-2-1, me 18.02.2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishtë e bazuar ankesa e OE AAB CONSTRUCTION SH.P.K., me nr. 2026/0023, e datës 09.01.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit ‘Ndërtimi i i parkut në Hajvali me numër të prokurimit 616-25-1776-5-2-1.
2. Anullohet, në tërësi aktiviteti me titull: ‘Ndërtimi i i parkut në Hajvali me numër të prokurimit 616-25-1776-5-2-1 e inicuar AK të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërishtë e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.03.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë B05, për aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i i parkut në Hajvali me numër të prokurimit 616-25-1776-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës 100,000.00 €.

Me 17.12.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë GOE: “NPT DAQA & NTP Lulishta Buçaj.

Me 22.12.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 31.12.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 09.01.2026, OE AAB CONSTRUCTION SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0023, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AAB CONSTRUCTION SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Deklarata mbi faktet dhe Argumentet

Të pa kënaqur me njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i i parkut në Hajvali me nr. te prokurimit: 616-25-1776-5-2-1 ne afatin ligjor konform ligjit, ushtrojmë këtë: A N K E S Ë Për shkak se AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES - Ne mënyrë te kundërligjshme e ka shpallur te pergjegjshem si dhe ka shpallur fitues kompanine N.P.T.Daqa & N.T.P Lulishtja Buçaj; ne procedurën e prokurimit ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i i parkut në Hajvali me nr. te prokurimit: 616- 25-1776-5-2-1 ndërsa kompania në fjalë është e eliminuar e ku do të sqarojmë edhe më poshtë Autoriteti Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES ka publikuar Njoftimi mbi vendimin e AK-se. Në këtë procedurë të tenderitmit ne jemi eliminuar nga kjo procedurë me pretekstin si në vijim;

Pavarësisht kësaj, në bazë të Rregullores nr. 26.16, kërkesa e Autoritetit Kontraktues për noterizim të dokumenteve konsiderohet e panevojshme dhe e pabazuar. Autoriteti Kontraktues, bazuar në nenet 69 dhe 72 të LPP-së, ka pasur mundësinë ligjore që të kërkojë sqarime dhe/ose plotësime për dëshmitë e kërkuara, ashtu siç janë përcaktuar në Dosjen e Tenderit (DT) dhe në Njoftimin për Kontratë. Konkretisht, për listën e projekteve dhe stafin profesional të lartcekur,

është dashur të kërkohej dhe të dorëzohen dëshmitë sipas kërkesave të përcaktuara në DT, e jo të vendosen kritere shtesë që nuk janë paraparë në dokumentacionin e tenderit. Pavarësisht faktit se Paneli Shqyrtues, në Ankesën e komapnisë spmë nr. 789/2025, ka kërkuar shprehimisht që të sigurohen informata shtesë, Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar sipas Vendimit të Panelit Shqyrtues, duke mos paraqitur kërkesën përkatëse për sqarime dhe duke mos respektuar udhëzimet e dhëna. Ku i gjitha dokumentacioni për të cilin jemi eliminuar ka mundur që të kërkohej në bazë të Nenit-72-Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, dokumente të cilat jemi të gatshëm edhe ti prezantojmë konform njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit:

Duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ne si Operator Ekonomik kemi ofruar çmimin ekonomikisht më të favorshëm për vlerësim, si dhe kemi paraqitur një periudhë garantuëse për punët e kryera më të gjatë sesa Operatori Ekonomik i cili është shpallur/pretendon për nënshkrimin e kontratës. Për këtë arsye, ne do të argumentojmë dhe specifikojmë shkeljet, si dhe kërkesat që nuk janë përmbushur nga ana e Operatorit Ekonomik të përgjegjshëm dhe pretendues për nënshkrimin e kontratës. Po ashtu, si në Vendimin e Panelit Shqyrtues, ashtu edhe në mendimin e Ekspertit Shqyrtues nr. 789/2025, lidhur me eliminimin tonë, është theksuar se nga ana juaj është dashur të kërkohej informata sqaruese për këtë pretendim. Megjithatë, ne nuk kemi pranuar deri më tani asnjë kërkesë për sqarim. Për rrjedhojë, kërkojmë nga ana juaj që të paraqitet kërkesa për informata sqaruese, në mënyrë që ne të kemi mundësinë të dëshmojmë se jemi Operator Ekonomik i përgjegjshëm dhe se përmbushim plotësisht kërkesat e dosjes së tenderit.

Shkeljet për të cilat N.P.T.Daqa & N.T.P Lulishtja Buçaj është dashur që të eliminohet.

Në dosjen e tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 është kërkuar:

2. Operatori ekonomike duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme:

4.a) Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, duhet të ketë dëshmi të punës në udhëheqje të kontratave të ngjajshme në periudhën tre vjeçare.

b) Inxhinier i diplomuar i industrisë së drurit së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

c) Arkitekt i diplomuar me 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Si dëshmi 2. a) OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emëron menaxherin e projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar. Të dëshmohet me CV'n e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt. Për pikat b), c), d), - Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme dhe kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt.

1) Për udhëheqësin e punishtes- si dëshmi është kërkuar:

a) Inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, duhet të ketë dëshmi të punës në udhëheqje të kontratave të ngjajshme në periudhën tre vjeçare.

Si dëshmi 2. a) OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emëron menaxherin e projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar.

Te dëshmohet me CV'n e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt.

GOE N.P.T. Daqa dhe N.T.P. Lulishtja Buçaj nuk kanë dorëzuar një deklaratë ku është emëruar menaxheri i projektit. GOE duhet të ishte eliminuar nga procesi. Duke e pasur parasysh që kjo ka qenë edhe kriter i vlerësimit në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit. Mungon CV-ja e nënshkruar e inxhinierit. Kjo është një kërkesë e rëndësishme për vlerësimin e kandidatëve dhe duhet të sigurohet një dokument i tillë. Duke e pasur parasysh që kjo ka qenë edhe kriter i vlerësimit në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit.

Referenca për punët e mëparshme është specifikuar angazhimi i Inxhinierit në projektet e kompanisë N.P.T Daqa mirëpo, në CV të prezantuar për inxhinierin, nuk është e cekur që ka punuar apo që ka qenë i angazhuar në projektet e kompanisë Daqa.

Kjo çështje është shtjelluar edhe në Vendimin e PSH nr. 789/25, ku në mënyrë të qartë është konstatuar se pretendimi ynë është i bazuar dhe qëndron. Në këtë vendim është saktësuar se dokumentacioni përkatës nuk është prezantuar, dhe për rrjedhojë Operatori Ekonomik në fjalë është dashur të eliminohet nga procedura e prokurimit. Nuk mund të pranohen si të rregullta dhe të vlefshme të gjitha dokumentet e dorëzuara më pas, përfshirë edhe vendimin për menaxherin/udhëheqësin e punishtes, pasi që ekzistenca e këtij dokumenti nuk ka qenë e dëshmuar në momentin e ofertimit dhe, si i tillë, nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit. Duke pasur parasysh se kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit nuk janë përmbushur, ky Operator Ekonomik është dashur të eliminohet nga procesi i vlerësimit të ofertave.

Duke pasur parasysh se nuk janë përmbushur kërkesat sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, është dashur që ky Operator Ekonomik të eliminohej nga procesi i vlerësimit.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që të prezantohen certifikatat. Iso 9001-2015, Iso 14001-2015, Iso 45001-2018, ISO 39001-2012.

Çertifikatat ISO janë ofruar vetëm nga lideri i grupit, mirëpo nuk ka paraqit ISO standardet dhe për anëtarin e grupit, duke u bazuar në Rregulloren Nr.001/2023 për Prokurim Publik Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik, paragrafi 26.6 Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik Çertifikatat për sigurimin e cilësisë/ përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë.

Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse.

29. 22.06.2023 Sipas nenit 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, në rast se AK kërkon Çertifikatë që vërteton përshtatshmërinë e produktit me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, në rast grupi të operatorëve, çertifikata e tillë a duhet të kërkohet nga të gjithë anëtarët e grupit apo mjafton njëri nga ata të jetë i pajisur me këtë çertifikatë?.

Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, “Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse 35 Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse”. Si rrjedhojë, kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001..., secili anëtar i grupit duhet të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë. Shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Si dhe ne piken 2 thuhet : Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume opereveve ekonomik. Pas ankesës sonë është kërkuar sqarim shtesë për këtë pikë mirëpo certifikatat e prezantuara nuk e përmbushin kërkesën pasi që është kërkuar si në vijim:

Operatori Ekonomik ose Furnizuesi i OE duhet të dorëzojë Certifikatat ISO Standarde që lidhen me natyrën e aktivitetit :

- Certifikata ISO Standard ISO 9001 2015;
- Certifikata ISO Standard ISO 14001 2015;
- Certifikata ISO Standard ISO 45001 2018;
- Certifikata ISO Standard ISO 39001 2012; Si dëshmi 6.Kopje e Certifikatave ISO me validitet për vitin 2025.

Më datë 02.03.2023 është realizuar lëshimi i parë i certifikatës ISO 39001:2012, duke konfirmuar përputhshmërinë e organizatës me kërkesat e standardit përkatës. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nuk rezulton se është kryer procesi i ricertifikimit, ashtu siç kërkohet edhe për certifikatat e tjera ISO, proces i cili është i domosdoshëm për ruajtjen e vazhdimësisë së vlefshmërisë së certifikatës. Po ashtu, nuk janë prezantuar certifikata të reja apo dëshmi zyrtare të lëshuara pas procesit të ricertifikimit, të cilat do të vërtetonin se certifikata ISO 39001:2012 ka qenë valide në momentin e ofertimit. Mungesa e këtyre dokumenteve nënkupton se nuk është dëshmuar vazhdimësia e vlefshmërisë së certifikatës sipas afateve të përcaktuara nga organi certifikues. Ricertifikimi përbën një hap të detyrueshëm dhe duhet të realizohet brenda afatit të përcaktuar nga organi certifikues, me qëllim që të garantohet se sistemi i menaxhimit vazhdon të përmbushë në mënyrë të vazhdueshme kërkesat e standardit ISO 39001:2012. Në mungesë të ricertifikimit dhe të dokumentacionit përkatës, kërkesa e Dosjes së Tenderit konsiderohet e papërmbushur.

Në bazë të kërkesës “Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik”, pika 6.4 (c), për situatën e referuar në pikën 6.3, kërkohet vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, që dëshmon se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është delikuent në pagesën e tatimeve, së paku deri në tremujorin e fundit të vitit përkatës. Anëtar i

GOE-së “Pleurant Buçaj B.I.” ka prezantuar vetëm vërtetim tatimor që dëshmon ekzistencën e një marrëveshjeje me këste për shlyerjen e borxheve tatimore, ndërsa nuk është prezantuar marrëveshja për shlyerjen e borxheve me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) e cila duhet të jetë e lidhur në mes ATK-SË dhe OE-së para datës së dorëzimit të tenderit. Për rrjedhojë, nuk mund të konstatohet se ky Operator Ekonomik përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 6.4 (c) të Dosjes së Tenderit, pasi mungon dokumentacioni i plotë dhe i vlefshëm që dëshmon mospasjen e detyrimeve tatimore të papaguara në momentin e ofertimit.

Duke pasur parasysh se nuk janë përmbushur kërkesat sipas Ligjit, Rregullores dhe Udhëzuesit të AK-së, ka qenë e nevojshme që ky Operator Ekonomik (GOE) të eliminohet nga procesi i vlerësimit.

Me vendimin dhe sqarimet që kemi dhënë, shihet qartë se Komisioni i Vlerësimit ka shkelur deklaratën nën betim, në kundërshtim me Nenet 1, 11 dhe 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 04/L237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092. Komisioni ka dështuar të zbatojë detyrën për të cilën ka nënshkruar deklaratën. Vlerësimi nuk është bërë në përputhje me ligjin, udhëzuesit dhe rregulloret përkatëse. Me eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit dhe me shpalljen fitues të OE i cili është i pa përshtatshëm dhe i pa përgjegjshëm AK e ka favorizuar drejt për se drejt OE-ne e rekomanduar për kontrate ndërsa na ka diskriminuar dhe na ka dëmtuar neve drejt për se drejt. Me këtë veprim AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu shihet qartë se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në pikën 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Ndërsa në pikën 2 thuhet:

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimet kundër eliminimit të parashtruesit: “Duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ne si Operator Ekonomik kemi ofruar çmimin ekonomikisht më të favorshëm për vlerësim, si dhe kemi paraqitur një periudhë garantuese për punët e kryera më të gjatë sesa Operatori Ekonomik i cili është shpallur/pretendon për nënshkrimin e kontratës. Për këtë arsye, ne do të argumentojmë dhe specifikojmë shkeljet, si dhe kërkesat që nuk janë përmbushur nga ana e Operatorit Ekonomik të përgjegjshëm dhe pretendues për nënshkrimin e kontratës”.

Pretendimet kundër tenderuesit të rekomanduar: “GOE N.P.T. Daqa dhe N.T.P. Lulishtja Buçaj nuk kanë dorëzuar një deklaratë ku është emëruar menaxheri i projektit. GOE duhet të ishte eliminuar nga procesi, duke e pasur parasysh që kjo ka qenë edhe kriter i vlerësimit në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Mungon CV-ja e nënshkruar e inxhinierit. Referenca për punët e mëparshme është specifikuar angazhimi i inxhinierit në projektet e kompanisë N.P.T Daqa, mirëpo në CV të prezantuar për inxhinierin nuk është cekur që ka punuar apo që ka qenë i angazhuar në projektet e kompanisë Daqa.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që të prezantohen certifikatat ISO 9001-2015, ISO 14001-2015, ISO 45001-2018, ISO 39001-2012. Certifikatat ISO janë ofruar vetëm nga lideri i grupit, mirëpo nuk janë paraqitur standardet ISO edhe për anëtarin e grupit. Më datë 02.03.2023 është realizuar lëshimi i parë i certifikatës ISO 39001:2012, duke konfirmuar përputhshmërinë e organizatës me kërkesat e standardit përkatës. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nuk rezulton se është kryer procesi i ricertifikimit, ashtu siç kërkohet edhe për certifikatat e tjera ISO, proces i cili është i domosdoshëm për ruajtjen e vazhdimësisë së vlefshmërisë së certifikatës. Po ashtu, nuk janë prezantuar certifikata të reja apo dëshmi zyrtare të lëshuara pas procesit të ricertifikimit, të cilat do të vërtetonin se certifikata ISO 39001:2012 ka qenë valide në momentin e ofertimit. Mungesa e këtyre dokumenteve nënkupton se nuk është dëshmuar vazhdimësia e vlefshmërisë së certifikatës sipas afateve të përcaktuara nga organi certifikues. Ricertifikimi përbën një hap të detyrueshëm dhe duhet të realizohet brenda afatit të përcaktuar nga organi certifikues, me qëllim që të garantohet se sistemi i menaxhimit vazhdon të përmbushë në mënyrë të vazhdueshme kërkesat e standardit ISO 39001:2012. Në mungesë të ricertifikimit dhe të dokumentacionit përkatës, kërkesa e Dosjes së Tenderit konsiderohet e papërmbytur”.

Parashtruesi po ashtu ka parashtruar pretendime ankimore sipas të cilave oferta e tenderuesit të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme për arsyet e prezantuara në kërkesën për rishqyrtim.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim: “Ju në ofertën tuaj nuk keni dëshmuar kopjet e certifikatave të noterizuara, si dhe test raportin që produktet e gomës të jenë antikancerogjene EN 771-3+A1 DIN 18035-7. Në ofertën tuaj mungojnë kopjet e certifikatave të noterizuara EN 117+AC dhe EN 1176-1, si dhe test raporti i kërkuar për produktet e gomës, duke bërë ofertën tuaj të papërgjegjshme”.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilës parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar, është gjetur se përderisa vetë parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj, është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Pavarësisht kësaj, vlen të thuhet që sa i përket pretendimeve kundër arsyeve eliminuese, parimisht as vetë parashtruesi nuk i ka kontestuar arsyet eliminuese. Pretendimi i tij manifestohet ashtu që AK qenka dashur t'i mundësojë parashtruesit që pas hapjes së ofertave të dorëzojë dokumentet që janë kërkuar me DT, duke u thirrur në emër të kërkesës për sqarime shtesë. Mirëpo, sipas nenit 72 të LPP, AK ka të drejtën (jo detyrimin) që të kërkojë sqarime shtesë vetëm nëse ka të paqartë ndonjë informacion lidhur me dokumentet që ekzistojnë në ofertë. AK nuk mund të ketë paqartësi dhe as të kërkojë sqarime për dokumente që nuk ekzistojnë (nuk janë bashkëngjitur) me ofertën.

Në rastin konkret, arsyet eliminuese janë se mungon një test raport dhe mungojnë 2 certifikata ISO të noterizuara. Natyrisht se nuk mund të kërkohej sqarime për dokumente që nuk janë bashkëngjitur (nuk ekzistojnë në ofertë). Kjo për arsye se nëse AK do të lejonte që të dorëzoheshin dokumente të reja pas hapjes së ofertave, kjo do të përbënte ndryshim thelbësor material të ofertës. Një ndryshim i tillë është i ndaluar përmes nenit 40.4 lidhur me nenin 38.2 të RRPP, ku përcaktohet se: “Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material aspekt të tenderit nuk mund të kërkohej, ofrohet ose lejohet”. Nga ky këndvështrim, pretendimi ankimor i parashtruesit është i pabazuar, ndërsa vendimi i AK sipas të cilit oferta e parashtruesit është eliminuar si e papërgjegjshme duhet të mbetet në fuqi.

Ndërsa sa i përket pretendimeve kundër tenderuesit të rekomanduar, parashtruesi pretendon se tenderuesi i rekomanduar nuk e ka dorëzuar deklaratën për menaxherin apo mbikëqyrësin e projektit, mungon CV e nënshkruar e inxhinierit, CV nuk përputhet me referenca, si dhe certifikatat ISO nuk kanë validitet. Këto pretendime janë të gjitha të pasakta, pasi që tenderuesi i rekomanduar me ofertë, por edhe me sqarimet shtesë të datës 19.07.2025, e ka prezantuar edhe deklaratën për menaxherin e projektit, edhe CV e nënshkruar të inxhinierit (e cila përputhet me referenca), si dhe certifikatat ISO me validitet. Pra, të gjitha dokumentet janë në platformën e e-prokurimi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 12.01.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0023, ndërsa me datë 27.01.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0023, me rekomandimet si në vijim Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, të anulohet Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 17.12.2025 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar pjesërisht rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit të tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE AAB CONSTRUCTION SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0023 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi ankimor nr 1.

Operatori Ekonomik nuk ka bërë renditjen numerike të pretendimeve ankimore mirëpo ne për qëllime të trajtimit i kemi ndarë si me poshtë:

OE ankues përmes pretendimi ankimor nr 1 thekson se AK-KK Prishtinë ka bërë shkelje të nenit 26.16 të Rr. PP nr 001/2022 dhe nenit 72 të LPP-se sepse sipas OE ankues këto të gjetura ka qenë e mundur të sqarohen sipas nenit 72 të Ligjit për Prokurim Publik.

OE ankues përmes letrës standarde mbi tenderuesin e eliminuar është eliminuar si i pa përgjegjshëm për arsyet në vijim:

- Ju në ofertën e juaj nuk keni dëshmuar kopjet e certifikatave të noterizuara si dhe test raportin që produktet e gomës të jenë antikancerogjene EN 771-3+A1 DIN 18035-7, në ofertën tuaj mungojnë kopjet e certifikatave të noterizuara dhe test raportin i kërkuar për produktet e gomës, duke bërë ofertën tuaj të pa përgjegjshme.

Sqarojmë se kërkesa në dosje të tenderit në lidhje me këtë pikë ka qenë:

Kërkesa:

5. OE duhet të ofroj certifikatën për cilësinë e gomes dhe standardin e tyre EN 1177 + AC EN1176-1

Dëshmia:

5. Kopjet e certifikatave të noterizuara si dhe test raportin që produktet e gomes të jenë antikancerogjene EN 771-3+A1 DIN 18035-7.

Në raportin e ekspertit të datës 03.09.2025 nr 2025/0789 e kemi trajtuar këtë pretendim ankimor.

Ashtu siç e kemi trajtuar tek raportin e ekspertit nr 2025/0789 të njëjtin mendim në lidhje me këtë pretendim ankimor e japim përsëri ku mendojmë se kemi të bëjmë me pretendim ankimor pjesërisht të bazuar dhe rekomandojmë që AK-Komuna e Prishtinës në fazën e rivlerësimit të veprave në përputhje me nenin 72 të LPP-se dhe të kërkojë sqarimet e nevojshme në përputhje edhe me vendimin e panelit nr 2025/0789 të datës 14.10.2025.

Përgjigje në pretendimet Ankimore në raport me N.P.T.Daqa & N.T.P Lulishtja Buçaj

Në lidhje me pretendimin ankimor të renditur si nr 2 që ka të bëjë në raport me ofertën e GOE NPT Daqa & NTP Lulishtja Buçja theksojmë se ky pretendim ankimor është trajtuar tek raportin i

ekspertit nr 2025/0789 ne renditje si pretendim nr 2.

Sipas këtij pretendimi ankimor GOE N.P.T. Daqa dhe N.T.P. Lulishtja Buçaj nuk kanë dorëzuar Deklaratën ku është emëruar menaxheri i projektit. GOE duhet të ishte eliminuar nga procesi. Duke e pasur parasysh që kjo ka qenë edhe kriter i vlerësimit në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne dosje te tenderit një kërkesë e tillë është kërkuar tek dëshmia si me poshtë: 2. a) OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emëron menaxherin e projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplumar. Te dëshmohet me CV'n e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt. Për pikat b), c), d), - Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme dhe kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt.

Ashtu siç e kemi traktuar këtë pretendim ankimor tek raporti i ekspertit ne 2025/0789 do te trajtojm edhe ne këtë rasport si ne vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron se një deklaratë e till mbi emërimin e menaxherit te kontratës mungon ne ofertën e OE te rekomanduar per kontratë, mirëpo sipas kërkesës per sqarime shtesë te datës 14.07.2025 rezulton se AK-Komuna e Prishtines ka kërkuar sqarimet edhe ne lidhje me deklaratën mbi emërimin e menaxherit te kontratës dhe pas kërkesës sonë per sqarime tek AK-me datë 03.09.2025 kemi pranuar sqarimet e ofruara nga OE i rekomanduar per kontratë dhe ne mesin e tyre gjendet edhe deklarata mbi emërimin e menaxherit te projektit. Emerimi i menaxherit te kontratës është obligative sepse kërkohet nënshkrimi edhe ne fazat e mëvonshme te ekzekutimit te kontratës duke filluar edhe nga Plani i Menxhimit te Kontrates (PMK) qe duhet te përgatitet nga te dy menaxheret e kontratave (AK dhe OE) andaj mbetet ne përgjegjësin e AK-së Komuna e Prishtines nëse një dokument i tillë i pranuar është ne harmoni me paragrafin 3 te nenit 72 te LPP-se sepse ekzistenca e tij para dorëzimit te tenderëve nuk mund te vërtetohet saktësisht.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 2 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor pjesërisht te bazuar.

Pretendimi ankimor nr. 3

OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 3 thekson se GOE Daqa dhe NTP Lulishtja Buçaj Mungon CV-ja e nënshkruar e inxhinierit. Kjo është një kërkesë e rëndësishme për vlerësimin e kandidatëve dhe duhet të sigurohet një dokument i tillë. Duke e pasur parasysh që kjo ka qenë edhe kriter i vlerësimit në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit.

Bazuar ne përshkrimin dhe rekomandimin e bërë per këtë pretendim ankimor edhe tek pretendimi ankimor nr. 3 sipas raportit nr 2025/0789 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor te pa bazuar.

Pretendimi ankimor nr.4

OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 4 thekson si ne vijim: Referenca për punët e mëparshme është specifikuar angazhimi i Inxhinierit në projektet e kompanisë N.P.T Daqa mirëpo, në CV të prezantuar për inxhinierin, nuk është e cekur që ka punuar apo që ka qenë i angazhuar në projektet e kompanisë Daqa.

Eksperti shqyrtues thekson se po ashtu ky pretendim ankimor është trajtuar tek raporti i ekspertit ne 2025/0789 ku kemi rekomanduar si te pa bazuar.

Në Letër Referencen e lëshuar nga OE NPT DAQA “Nexhmedin Sadiku” B.I , per Inxhinierin ceken nje numër i madh i projekteve ne te cilat inxhinieri përkatës ka punuar ne projektet e këtij operatori ekonomik andaj si e tillë OE dhe inxhinier mbajn përgjegjegjesin për vëtetesin e tyre.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm tek pretendimi ankimor nr. 4 konstatojm se kemi te bëjmë me pretendim ankimor te pa bazuar.

Pretendimi ankimor nr. 5

Sipas këtij pretendimi ankimor OE ankues thekson Në dosjen e tenderit është kërkuar që të prezantohen certifikatat. ISO-9001-2015, ISO-14001-2015, ISO-45001-2018, ISO-39001-2012, Çertifikatat ISO janë ofruar vetem nga lideri i grupit, mirëpo nuk ka paraqit ISO standardet dhe per anëtarin e grupit, duke u bazuar ne Rregulloren Nr.001/2023 për Prokurim Publik.

Ky pretendim ankimor ne raportin e ekspertit nr 2025/0789 ka qenë i traktuar si pretendim ankimor nr. 9.

Bazuar ne përshkrimin e pretendimit ankimor dhe sipas nenit 26.6 te Rr. PP nr 001/2022 dhe plotësim ndryshimi përmes Rr,nr 002/2024, ne raportit e eksperit nr 2025/0789 kemi rekomanduar se AK-Komuna e Prishtine ne procedurën e rivlerësimit te kërkoj informata shitesë sipas nenit 72.3 te LPP-se dhe nenit 38 te Rregullores per Prokurim Publik. Rekomandimin e kemi mbështetur ne faktin se ISO Standardet janë dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive nëse janë lëshuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, pra ka qenë i trajtuar si pretendim ankimor pjesërisht i bazuar.

Sipas OE ankues tek ky pretendim certifikata ISO 39001:2012 më datë 02.03.2023 është realizuar lëshimi i parë i certifikatës ISO 39001:2012, duke konfirmuar përputhshmërinë e organizatës me kërkesat e standardit përkatës. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nuk rezulton se është kryer procesi i ricertifikimit, ashtu siç kërkohet edhe për certifikatat e tjera ISO, proces i cili është i domosdoshëm për ruajtjen e vazhdimësisë së vlefshmërisë së certifikatës. Po ashtu, nuk janë prezantuar certifikata të reja apo dëshmi zyrtare të lëshuara pas procesit të ricertifikimit, të cilat do të vërtetonin se certifikata ISO 39001:2012 ka qenë valide në momentin e ofertimit. Mungesa e këtyre dokumenteve nënkupton se nuk është dëshmuar vazhdimësia e vlefshmërisë së certifikatës sipas afateve të përcaktuara nga organi certifikues. Ricertifikimi përbën një hap të detyrueshëm dhe duhet të realizohet brenda afatit të përcaktuar nga organi certifikues, me qëllim që të garantohet se sistemi i menaxhimit vazhdon të përmbushë në mënyrë të vazhdueshme kërkesat e standardit ISO 39001:2012. Në mungesë të ricertifikimit dhe të dokumentacionit përkatës, kërkesa e Dosjes së Tenderit konsiderohet e papërmbushu

Sqarojm se certifikata ISO 39001:2012 e dorezuar pas kërkesës per sqarime shitesë nga GEO i rekomanduar per kontratë me datë 24.11.2025 ; ora 13:30, përmes E-prokurimit ka validitet deri me datë 01.03.2026.

Po ashtu nga verifikimi i realizuar me datë 23.01.2026; ora 11:01 ne ëeb faqen e trupës certifikuese qe ka lëshuar këtë certifikate rezulton se certifikata ka validitet, shih foton ne vijim:

Andaj duke u bazuar ne përshtetimin e mësipërm konstatojm pretendimi ankimor nr. 5 është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor nr. 6

Sipas OE ankues Anëtar i GOE-së “Pleurat Buçaj B.I.” ka prezantuar vetëm vërtetim tatimor që dëshmon ekzistencën e një marrëveshjeje me këste për shlyerjen e borxheve tatimore, ndërsa nuk është prezantuar marrëveshja për shlyerjen e borxheve me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) e cila duhet të jetë e lidhur në mes ATK-SË dhe OE-së para datës së dorëzimit të tenderit. Për rrjedhojë, nuk mund të konstatohet se ky Operator Ekonomik përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 6.4 (c) të Dosjes së Tenderit, pasi mungon dokumentacioni i plotë dhe i vlefshëm që dëshmon mospasjen e detyrimeve tatimore të papaguara në momentin e ofertimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne rastet kur Vërtetimi Tatimor rezulton me borxhe duhet te arrihet marrëveshja mbi shlyerjen e borxheve ne mes te operatorit ekonomik dhe Administrates Tatimore te Kosoves mbi programimin e borxhit. Afatet kohore te marrëveshjes duhet te jenë ne harmoni me interpretimin e KRPP-se te datës 22.11.2022 , shih ne vijim:

6. 22.11.2022 A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 te LPP përcakton: 4.8 “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;” Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi “aktualisht” nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë “të pranueshëm” për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE- të janë “të pranueshëm” kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë “Deklaratën nën betim” me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Ne përputhje me paragrafin 5 te nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë “i pranueshëm”, pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë.

Bazuar ne interpretimin e KRPP-se te datës 22.11.2022 konstatojm se nëse ndonjëri nga anëtarët e grupit te operatoreve ekonomik kanë dorëzuar Vetëtimin tatimor me borxhe ku theksohet se janë ne marrveshje me pagesën e borxhit me ATK-në atëherë marrveshja mbi shlyerjen e borxheve duhet te jetë para datës se publikimit te njoftimit per kontratë.

Me datë 23.01.2026 kemi kërkuar sqarime nga AK-Komuna e Prishtines ku kemi kërkuar, si ne vijim:

- Na dërgoni përmes emailit Vërtetimin Tatimor dhe Marrëveshjen mbi pagesën e borxheve te anëtarit te GOE te rekomanduar per kontratë: "Pleurat Buçaj" B.I. Me gjerësisht i referoni shkresës Clarfication_188. AK-Komuna e Prishtinës me datë 26.01.2026 ka kthyer pergjigjen e kërkuar.

Nga dokumentet e ofruara nga Komuna e Prishtines konstatojm se OE Pleurat Buçaj B.I ka ofruar Vërtetimin e ATK-së te datës 30.09.2025 ku theksohet se është i rexhistruar ne ATK dhe është në marrëveshje me këste per te shlyer borxhet e tatimore te mbetura.

Po ashtu marrëveshja e ofruar me ATK-ne me nr protokoli 5179 është e datës 12.09.2025. Nga kjo rezulton se te dy dokumentet (Vërtetimi i ATK-se dhe Marrëveshja) janë pas date se Njoftimit per kontratë. Duke u bazuar ne interpretimin e KRPP-se ku theksohet “KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës”.

Po ashtu pjesë e këtij interpretimi është edhe interpretimi “Ne përputhje me paragrafin 5 te nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm.

Andaj bazuar ne këtë interpretim kemi te bejmë me afat kohorë te gjatë nga data e njoftimit per kontratë (12.03.2025) dhe deri te data e Njoftimit mbi vendimin e AK-së (17.12.2025) dhe ne këtë menyrë obligimet mund te lindin ne faza te ndryshme kohore.

Andaj duke u bazuar ne përshkrimin e mësipërm konstatojm pretendimi ankimor nr. 6 është pjesërisht i bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 dhe 7 te LPP-se pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të

gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë OSHP-në dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues gjate administrimit të provave në këtë procedur ku , dhe për këtë procedur është nxjerur vendimi paraprak i OSHP-së me nr 2025/0789 . AK-ja gjatë 7 rivlersim ka pasur mundësi të aplikon nenin 72 të LPP-së, mirpo edhe OE ankues ka dështuar të dëshmoj edhe në ankes pran OSHP-se për çka edhe është eliminuar lidhur me kërkesën nr 5 të DT-së ku është kërkuar citoj *5. OE duhet të ofroj certifikaten per cilesin e gomes dhe standardin e tyre EN 1177 + AC EN1176-1, Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 5. Kopjet e certifikatave te noterizuara si dhe test raportin qe produktet e gomes te jenë antikancerogjene EN 771-3+A1 DIN 18035-7”... . Në ofertën e OE ankues mungon testi i raportet që dëshmojnë se produktet e gomës të jenë antikancerogjene . Poashtu PSH vëren se kërkesa, dhe dëshmit e dokumentuara nuk janë në harmoni njëra me tjetrën. Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë nga AK-ja, Paneli Shqyrtues analizoj edhe ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se OE lidhur me pretendimin ankimor 2. a) OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emëron menaxherin e projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar , ne listën e punëtorve të OE të rekomanduar menaxher i puntoreve është caktuar D.SH , Menaxher dhe instruktor në vendin e punes është caktuar E.S , mirpo mungon menaxheri i projektit , ku edhe në ofertë nuk ka ndonjë vendim mbi caktimin e menaxherit të projektit , poshtu lidhur me pretendimi ankimor nr. 6. Anëtar i GOE-së “Pleurat Buçaj B.I.” ka prezantuar vetëm vërtetim tatimor që dëshmon ekzistencën e një marrëveshjeje me këste për shlyerjen e borxheve tatimore, dhe bazuar ne interpretimin e KRPP-se te datës 22.11.2022 se nëse ndonjëri nga anëtarët e gruput te operatoreve ekonomik kanë dorëzuar Vetetimin tatimor me borxhe ku theksohet se janë ne marrveshje me pagesën e borxhit me ATK-në atëherë marrveshja mbi shlyerjen e borxheve duhet te jetë para datës se publikimit te njoftimit per kontratë, marrëveshja e ofruar me ATK-në me nr protokoli 5179 është e datës 12.09.2025. dhe nga kjo rezulton se te dy dokumentet (Vërtetimi i ATK-se dhe Marreshja) janë pas date se publikimit të Njoftimit per kontratë. Andaj nga gjithë të gjeturat në këtë procedur, Paneli Shqyrtues konstaton se sikurse OE i rekomanduar për kontrat edhe OE ankues nuk i përmbushin kërkesat e NJK dhe DT-së sikurse parashihet në nenin 51, 56 dhe 60 të LPP-së .

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues në mbështetje të neninit 1 dhe 7 të LPP-së dhe nga të gjeturat në këtë procedur sikur janë përshkruar më lartë , e aprovon pjesërishtë ankesën, ndërsa aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i i parkut në Hajvali me numër të prokurimit 616-25-1776-5-2-1, e anulon në tërsi procedurën, duke kërkuar nga AK-ja në rastë të ri-tenderimit, ti përmbahet në tërsi dispozitave ligjore sikurse parashihen në LPP.

-Përfundim –

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit

të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - AAB CONSTRUCTION SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: